



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 28.02.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.02.2024, të parashtruar nga Operatori ekonomik "PM GROUP" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material higjienik për shkolla", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-1090-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-009-121, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: "PM GROUP" SH.P.K., e dt.27.02.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me material higjienik për shkolla", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-1090-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-009-121, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë të AK -së, të datës 14.02.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË e publikuara me datë: 14.02.2024;**

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "PM GROUP" SH.P.K., me dt.27.02.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material higjienik për shkolla", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-1090-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-009-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 28.02.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se Autoriteti kontraktues nuk i është përgjigjur kërkesës suaj të dt.20.02.2024, për sqarime shtesë nuk qëndron, sepse kërkesa juaj për sqarime shtesë nuk është ngarkuar në e-prokurim ku duhet të ngarkohet – te funksioni "Sqarimet e DT"(fig1)



Me dt 23.02.2024, Autoriteti kontraktues , ka kthyer përgjigje tek "Sqarimet e DT"(shih fig.):



Prandaj pretendimi juaj se Autoriteti kontraktues nuk i është përgjigjur kërkesës juaj për sqarime shitesë dhe ka bërë shkelje të LPP-së, është i pa bazuar;  
Sa i përket pretendimit tuaj lidhur me ISO 9001-2015-menaxhimi i cilësisë së mirë, sqarojmë se Autoriteti kontraktues në DT ka kërkuar që në bazë të rekomandimit të KRPP-së të dt.17.06.2022, Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë ISO 9001-2015-menaxhimi i cilësisë së mirë, me çka nënkupton se produkti i Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me këto ISO, e në rastin kur ju jeni furnizues/i autorizuar e jo prodhues, duhet të prezantoni ISO-t e prodhuesit bashkë me autorizimin e prodhuesit të produkteve. Prandaj pretendimi juaj se po bëjmë diskriminim dhe se me këto ISO janë të pajisur vetëm Operatorët ekonomik që janë prodhues nuk qëndron, sepse kërkesa nuk ka të bëjë vetëm me furnizuesin.

Për sqarimin tuaj , Autoriteti kontraktues ende është në fazën para hapjes së tenderit dhe nuk ka bërë Njoftimin mbi vendimin e AK-së(formulari B58).

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj  
  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit  
